

VENDIM
Nr.72, datë 12.12.2007

PËR MIRATIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURAVE PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SHOQËRISË “OSSH” SHA

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13, pika 1, germa “c” dhe nenit 19, pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me ndryshimet përkatëse dhe nenit 10, pika 1 të “Rregullave për procedurat e licencimit”, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 12.12.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “OSSH” sh.a., për licencim në aktivitetet e shpërndarjes së energjisë elektrike,

VENDOSI:

- Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “OSSH” sh.a., për licencimin në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për dërgimin e dokumenteve të munguara, në përputhje me kërkesat e “Rregullores për procedurat e licencimit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta